



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 26 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi - kryetar i Komisionit, Behar Selimi – nënkryetar, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Haki Demolli, Mufera Šinik dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fjolla Uka – NDI, Luz Balaj, Petrit Hysaj – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Shefki Kastrati – NDI, Isuf Zejna – KDI, Vlora Marmullakaj – EULEX, Haxhi Gashi – USAID, Niman Racaj – KPM, M. Sokoli – ICO, Dren Selimi – ICO, Fixhrije Dragaj – Asistente e GP AAK, Ardita Zejnullahu – AMPEK, Eroll Gashi, Fjolla Krasniqi dhe Fitore Sadiku – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi - Kryetar i Komisionit

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-99 për ndryshimin dhe plotësimin e kodit doganor dhe të akcizave nr. 03/L-109;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-104 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-204 për tatimin në pronën e paluajtshme;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat e korporatave;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që pikat tre, katër, pesë dhe gjashtë të hiqen nga rendi ditës, sepse ka referenca në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, prandaj edhe duhet të harmonizohen me këtë Projektligj.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë

Arben Gashi - Paraqiti shqetësimet rreth amendamentit 16. Në të, sipas tij, parashihet trajtim i ndryshëm për kandidatët në gjuhën serbe në krahasim me kandidatët në gjuhën shqipe. Me këtë krijohen procedura të ndryshme, me të cilat përcaktohen rregulla të veçanta të zgjedhjes së drejtorit të kanalit në gjuhën serbe. Për mendimin tim, mënyra si është rregulluar kjo çështje, nuk është në harmoni me Kushtetutën.

Albulena Haxhiu - U pajtua me parafolësin. Tha se edhe ata janë kundër amendamentit 16. Nuk mendon se ky amendament është në pajtim me Kushtetutën.

Behar Selimi - Unë e kam një tjetër shqetësim, rreth amendamentit 8, ku flitet për nenin 18. Ndoshta ky amendament bie ndesh me Kushtetutën, meqë në nenin 141 flitet për Komision e Pavarur për Media.

Arsim Bajrami - Komentet i adresoi në amendamentet 3 dhe 16. Te amendamenti 3 flitet për pronën e RTK-së. Kjo për mua është në rregull, nëse prona është e pakontestueshme. Por sa jam i njoftuar unë, atje kemi një kontest pronësor. Kjo do të thotë se duhet të pritet vendimin i gjykatës, sepse Qeveria nuk mund të vendosë për një çështje që është në procedurë kontestimore. Nuk jam i sigurt nëse ka përfunduar kontesti. Te amendamentit 16, nëse e lexoni, ka asimetri. Procedura e drejtorit në gjuhën serbe është e ekzagjeruar, e detajuar. Mirëpo kjo nuk është hera parë, sepse kemi rastet e përfaqësuesve të policisë, ku kemi pasur procedura më të ekzagjeruara. Mua kjo nuk më pengon, sepse në fund, të dy drejtorët, si për kanalën e parë, si për kanalën e dytë, zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve. Pra, në këtë rast, nuk mendoj se dëmtohet procesi.

Armend Zemaj - Mendoj se po ndërtohet një praktikë e keqe. Edhe zgjedhja e drejtorit të kanalit në gjuhën serbe do të ndikojë të krijohet një precedent, që do të shkaktojë probleme në të ardhmen. Raporti ndërmjet transmetuesit publik dhe KPM-së, rezulton me një zbehje të autoritetit të KPM-së në krahasim me transmetuesin publik. Kjo për faktin se gjersa transmetuesit e tjerë privatë i nënshtrohen KPM-së, në disa nene, transmetuesi publik ngel jashtë KPM-së, pra nuk i nënshtrohet autoritetit të saj. Në një formë kjo është padrejtësi ndaj medimeve të tjera.

Jasmina Zhivković – Për amendamentin 16 tha: Edhe pse nga parafolësit u vlerësua se nuk është në pajtim me Kushtetutën, mendoj se në Planin e Ahtisarit është paraparë kanali i pavarur në gjuhën serbe. Sipas saj ky është një definim shumë i gjerë. Me këtë amendament mund të sigurohet një minimum i minimumit që të ekzistojë kjo pavarësi e përcaktuar me Kushtetutë. Bordi i RTK-së, mendoj se është i përfshirë në përzgjedhjen e komisionit që i propozon kandidatët për kanalën në gjuhën serbe. Pra, them se ky amendament nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

Amir Ahmet – Vlerësoi se amendamenti 16 duhet të mbetet ashtu siç është propozuar, sepse nuk mendon se është në kundërshtim me Kushtetutën.

Halit Krasniqi - Jam për t'u shqyrtuar të gjitha vërejtjet. Nga ato që shoh, nuk kam ndonjë shqetësim pse është ngritur Bordi për Zgjedhjen e Drejtorëve, sepse Bordi e cakton një grup pune prej 7 anëtarëve, ku 4 prej tyre janë të komunitetit serbë dhe ata në fund i propozojnë Bordit të Drejtorëve kandidatët për drejtorë. Po shoh se komuniteti serb është mjaft i pranishëm në zgjedhjen e drejtorit. Jam që të përkrahet ky amendament. Nuk mendoj se shqetësimet e deputetit Armend Zemaj janë aq shumë për t'u vlerësuar.

Haki Demolli - Ngriti shqetësimin e tij rreth amendamentit 3. Shtoi se duhet të kemi kujdes nëse Kuvendi mund të vendosë për pronën e RTK-së. Nëse çështja është në kontest, kjo do të thotë se duhet të presim që ajo të sqarohet nga gjykata, me qëllim që të mos zbatojmë praktika që janë në mospajtim me Kushtetutën.

Ardian Gjini - Gjatë gjithë kësaj kohe jemi munduar që punën tonë ta drejtojmë, me qëllim të depolitizimit të transmetuesit publik. Ne nuk jemi kundër përfaqësimit të pakicave, por kundër mënyrës si po kërkohet të arrihet ky përfaqësim. Kjo s'ka të bëjë me të drejtat e pakicave, por me politikat e pakicave dhe me politikën e Qeverisë. Aleanca nuk e ka problem të ketë programe edhe të komuniteteve të tjera, por duhet të ketë interpretim të drejtë. Këtu ka politikë të pakicave. Ne parimisht nuk mund të jemi pro pakicave dhe kundër shumicës. Politikanët e pakicave, që janë në pushtet, po mundohen ta kontrollojnë pjesën në Radio Televizionin e Kosovës. Të mos e kamuflojmë situatën, sepse jemi duke instaluar dy sisteme të ndara, që nuk do të sjellin asgjë të mirë as për vetë pakicat.

Behar Selimi – E mori sërish fjalën. Tha se përderisa e njëjta praktikë është zhvilluar te përfaqësuesit e policisë dhe nuk ka pasur dëmtim të procesit, mendoj se as në këtë rast nuk do të dëmtohet procesi.

Armend Zemaj - Besoj se ky proces ka filluar keq, edhe përfundimin do ta ketë të tillë. Shikojeni skemën e RTK-së. Dy kanalet nga 15 për qind të programit do t'i kenë për komunitete. Kjo nënkupton që në transmetuesin publik në gjuhën shqipe do të flitet shumë pak. Po ashtu është bërë ndërhyrje në linjën e buxhetit prej 0.8 për qind. Kjo është dashur, në mënyrë kronologjike, të harmonizohet më herët me ligjet e tjera.

Albulena Haxhiu - Po më vjen keq nga fakti si deputetët e opozitës po mundohen ta relativizojnë situatën. Unë besoj se do të kemi probleme shumë të mëdha në të ardhmen.

Arben Gashi - Në koncept mendoj se Projektligji është ndërtuar gabimisht. Nuk është mirë të ketë ndarje midis komuniteteve. Zgjidhja më e mirë do të ishte që të gjitha komunitetet të kenë një kanal dhe përqindja kohore të ndahet në bazë të përqindjes së popullsisë. Po krijohet një disbalancë totale midis hapësirave programore, duke përfshirë edhe programin në gjuhën shqipe.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion nxori këtë

Përfundim

*I. Komisioni vlerësoi se amendamenti 8 duhet të harmonizohet me Ligjin për KPM-në, kurse amendamenti 9, ku thuhet se “**çdo vit RTK-së i ndahet 0.8% e të hyrave nga buxheti i Kosovës**”, është në kundërshtim me Ligjin për buxhetin. Komisioni, po ashtu, është kundër amendamentit 16 për*

përcaktimin e një procedure të veçantë, me të cilin përcaktohen rregulla të veçanta të zgjedhjes së drejtorit të kanalit në gjuhen serbe.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit, me sugjerimet e dhëna.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi